



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0352

2024/0360

2024/0362

2024/0367

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim - Kryesuese, Isa Hasani - anëtarë dhe Vedat Poterqoi - anëtarë duke vendosur sipas ankesës së OE “Mabco Constructions” SH.P.K me nr. 2024/0352, ankesës së “Nika Proing” me nr. 2024/0360, ankesës së OE “AK-Invest Dooel” me nr. 2024/0362 dhe ankesës së OE “Ada Consulting Group” SH.P.K me nr. 2024/0367, kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK” me numër të prokurimit: 206-23-14371-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, më 11/09/2024, me shumicë votash mori këtë:

Vendim

1. Aprovohen pjesërishtë si të bazuara ankesa e OE “Ada Consulting Group” SH.P.K me nr. 2024/0367, ankesa e OE “AK-Invest Dooel” me nr. 2024/0362, si dhe ankesa e OE “Mabco Constructions” SH.P.K me nr. 2024/0352, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK” me numër të prokurimit: 206-23-14371-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Refuzohet si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik “Nika Proing” me nr. 2024/0360.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës së OE “Ada Consulting Group” SH.P.K dhe “AK-Invest Dooel”, OE “Mabco Constructions” SH.P.K.

5. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës së OE “Nika Proing” me nr. 2024/0360.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 08.01.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK” me numër të prokurimit: 206-23-14371-5-1-1. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Punë, vlerë e madhe, vlera totale e parashikuar e kontratës: 22,513,201.67 €. Me datën 02.04.2024 është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës ku AK shpërblen me kontratë Operatorin Ekonomik “BM Group”. Të pakënaqur me vendimin e AK-së, OE “Mabco Constructions” SH.P.K me datën 05.04.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Poashtu kërkesë për rishqyrtim ka dorëzuar me datën 07.04.2024 edhe OE “Ada Consulting Group” SH.P.K. Kërkesë për rishqyrtim në AK me datën 08.04.2024 kanë parashtruar edhe OE “NIKA PrO- Ing” SH.P.K dhe OE “Invest Dooel”. Autoriteti Kkontraktues i ka refuzuar kërkesat për rishqyrtim të OE-ve të lartcituara me datën 16.04.2024. Të pakënaqur me vendimin e kërkesave për rishqyrtim, OE “Mabco Constructions” SH.P.K ka parashtruar ankesë me nr. 2024/0352, OE “Nika Proing” ankesën me nr. 2024/0360, OE “Invest Dooel” ankesën me nr. 2024/0362 dhe OE “Ada Consulting Group” SH.P.K ankesën me nr. 2024/0367. Në fazën e shqyrtimit paraprak: (a) OSHP ka konstatuar se ankesat në rastin konkret janë dorëzuar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bje nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizo i të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizo i të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsidero i se është e nevojshme të mbahet seanca dëgjimore (e mbajtur me datën: 27.08.2024), me palë sikurse parashihet në Rregulloren e Punës së OSHP-së. (b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes

dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me ketë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me ketë, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me nr. 2024/0352, 2024/0360, 2024/0362 dhe 2024/0367, rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim: Ankesa nr. 362/24, ankesa 367/24 të aprovohen si pjesërisht të bazuara Ankesa Nr. 352/24 dhe ankesa Nr. 360/24 të refuzohen sit ë pabazuara Të kthehet në rivlerësim vendimi i AK-së Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Mabco Constructions” sh.p.k Nr. 352/24 Konstatimi parë (I): Kërkesa është parashtruar me 05.04.2024 dhe Vendimi për refuzim është publikuar me 16.04.2024. Pretendimi ankimor i OE se AK nuk ka respektuar afatin ligjor për përgjigje në kërkesë për rishqyrtim është i bazuar, pasi që sipas nenit 108/A afati maksimal për nxjerrje të vendimit është 3+3 ditë pune. Konstatimi dytë (II): Duke u bazuar në pikën ankimore të OE - MABCO Constructions SH.P.K. për Planin dinamik, në njërën anë, si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi në fushën e ndërtimit në Republikën e Kosovës në anën tjetër, Eksperti teknik konstaton: Bazuar në legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës në fushën e ndërtimit, nuk ka ndonjë dispozitë e cila e përcakton formën grafike të “planit dinamik” për zhvillimin e punëve. Andaj, vlerësuar vetëm në aspektin profesional, mund të vlerësohet që është në diskrecion të AK-ve të përcaktojnë formatet e standardizuara, të cilat do f i plotësonin të gjitha kriteret e përcaktuara sipas kërkesës dhe specifikave të tenderit, si dhe do të ishin më të lehta për interpretim dhe vlerësim sa më të drejtë nga personeli i tyre (AK-së). Pas shqyrtimit të dokumentit të bashkangjitur nga OE - MABCO Constructions SH.P.K. në dosje të tenderit, me emrin “Plani dinamik Final Klinika Emergjente 13.02.2024” formati pdf, është vërtetuar që: i njëjti nuk është sipas formatit të kërkuar nga AK (exel - dy faqe) dhe se nuk i përmban të gjitha të dhënat të cilat i përmban formati i kërkuar nga AK (ditët totale për kryerjen e punimeve sipas pozicioneve), pra nuk është i njëjtë as për nga forma as për nga përmbajtja, si dhe nuk është ekuivalent me kërkesën e AK-së. Bazuar në konstatimet e mësipërme, pretendimi i OE ankues hidhet si i pabazuar. Konstatimi tretë (III): Në lidhje me pretendimin e OE ankimor për Kërkesën mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 gjegjësisht mosplotësimin e Dëshmisë së kërkuar dokumentare për Certifikatat profesionale valide për ISO 9001, 14001,45001 dhe 3834-2, si dhe sqarimeve të AK-së, dt. 05.02.2024. Eksperti shqyrtues sqaron se sipas dosjes së tenderit, kjo kërkesë është kërkesë mbi kapacitetin teknik/profesional dhe si e tillë në pajtim me dispozita të LPP-së dhe legjislacionit sekondar, kërkesat për kapacitet profesional/teknik aplikohen ndaj grupit si tërësi, e jo ndaj secilit anëtar veç e veç. Megjithëse AK përmes “sqarimeve” ka konstatuar se Certifikatat për ISO 9001, 140001 dhe 45001 kërkohen për të gjithë anëtarët e grupit, AK nuk ka bërë korrigjimin e Dosjes së tenderit dhe si rrjedhojë tani kemi kërkesa kundërthënëse në dosje të tenderit dhe sqarimeve të dhëna nga AK. Meqë kërkesa në dosje të tenderit dallon nga sqarimet e dhëna, në mungesë të dispozitave të përshtatshme të LPP-së për kërkesa të paqarta të dosjes, eksperti shqyrtues bazuar në parimet e ligjit të mardhënieve dhe detyrimeve neni 86 - Dispozitat e paqarta, në raste të veçanta, rastin kur kontrata është lidhur sipas përmbajtjes së shtypur që më parë, ose kur kontrata ka qenë në ndonjë mënyrë e përgatitur d/ie e propozuar nga njëra palë kontraktuese, dispozitat e paqarta do të interpretohen në dobi të palës tjetër”. Andaj vlersojmë se edhe kërkesat e dosjes të ndryshuara përmes “sqarimeve” të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e dosjes, duhet të interpretohet në dëm të hartuesit të dosjes, gjegjësisht në dëm të

Autoritetit kontraktues dhe në dobi të OE-ve ofertues. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar. Konstatimi katërt (IVa): Pretendimi i ngritur nga OE ankues, se OE i rekomanduar ka shkelur në tërësi dispozitat ligjore dhe pikën e dosjes së tenderit: “Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme-ndërtim ose renovim i objekteve të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 50% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. Së paku në njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj. Nuk pranohen objektet individuale, ambulanta, projekte rrugore, ura, ujësjellës, kanalizime, e të ngjashme”. Eksperti shqyrtues sqaron se meqë kërkesa në dosje të tenderit dallon nga sqarimet e dhëna, në mungesë të dispozitave të përshtatshme të LPP-së për kërkesa të paqarta të dosjes, eksperti shqyrtues bazuar në parimet e ligjit të mardhënieve dhe detyrimeve neni 86 - Dispozitat e paqarta, në raste të veçanta, “Aë rastin kur kontrata është lidhur sipas përmbajtjes së shtypur që më parë, ose kur kontrata ka qenë në ndonjë ntënyrë e përgatitur dhe e propozuar nga njëra palë kontraktuese, dispozitat e paqarta do të interpretohen në dobi të palës tjetër”. Andaj vlerësojmë se edhe kërkesat e dosjes të ndryshuara përmes “sqarimeve” të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e dosjes, duhet të interpretohet në dëm të hartuesit të dosjes, gjegjësisht në dëm të Autoritetit kontraktues dhe në dobi të OE-ve ofertues. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është i pabazuar. Konstatimi katërt (IVb): Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar nga AK, përmes listës së projekteve të realizuara në vlerë totale prej 30,901,003.51 euro, ka përfshirë në listën 25 projekte, dhe se shumica janë projekte individuale, infrastrukturore e të ngjashme, Eksperti teknik në bazë të gjetjeve konstaton: OE i rekomanduar në listë të projekteve të realizuara ka paraqitur 25 projekte, ndërsa tek referencat ka 23 sosh, meqë në 2 (dy) prej tyre ka aneksë kontrata. Gjatë elaborimit të tyre është vërejtur: 2 (dy) Referenca (Demolation and Landscaping Central Vaccine dhe Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së) nuk kanë nënshkrim, prej tyre njëra (1) nuk ka çmim të përshkruar (Demolation and Landscaping Central Vaccine) dhe tjetra është realizuar deri në masën 85% (Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së); 1 (një) tjetër është në proces e sipër (Punimet në Parkun Industrial në Drenas); 1 (një) është vetëm fumizim (Fumizimi për ndërtimin e objektit afaristo-banesor të investitorit Pozhegu Brothers). Lidhur me projektet: Ndërtimi i Stadionit të qytetit në Gjilan, Faza e parë - Renovimi i stadiumit në Gjakovës, Faza e dytë - Ndërtimi i stadiumit të qytetit Drenas, Ndërtimi i Parkut Industrial në Miradi, ndërtimi i Fakultetit të FSHMN-së - Prishtinë, Ndërtimi i stadiumeve ndihmëse në Gjilan, Pejë, Drenas dhe Studenqan, Fumizimi dhe ekzekutimi i punëve në

parkingut në Prishtinë, Ndërtimi dhe fumizimi i ndërtimit në Lagjen Marigona Flill, Fumizimi me beton për ndërtimin e objekteve afaristo-banesore për Pozhegu Brothers. Për të gjitha këto projekte OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar kontrata dhe referenca, të cilat nuk dëshmojnë realizimin/përfundimin e suksesshëm të këtyre projekteve. Përkundrazi në këto referenca shënon “Referencë pozitive ... prej fillimit të kontratë deri më sot...”, “realizim i punimeve deri në masën 85%”, “... në punimet që po zhvillohen ...”, “... me sukses e ka përfunduar pjesërisht furnizimin ...”, e të ngjashme. Duke u bazuar në këto konstatime, me të

cilat vërtetohen se OE i kontraktuar nuk ka përfunduar në tërësi punët sipas

marrëveshjes kontraktuale, pastaj kontrata me vetëm furnizim, si dhe kontrata të kombinuara furnizim dhe punë, rezulton që OE i rekomanduar nuk e arrin shumën e kërkuar me dosje të tenderin në vlerën prej 25,000,000.00 euro. Në lidhje me dyer X-Ray hapje automatike, OE i rekomanduar nga AK e posedon dhe e vërteton me Kontratën e lidhur me UNOPS për Rehabilitimin e Klinikës së Radiologjisë në Ferizaj, konkretisht në kapitullin Annex A - Bill of Quantity (Bill 2). Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, eksperti shqyrtues/teknik vlerësojnë se pretendimet ankimore të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën për punë të ngjashme në vlerë 25.000.000€ janë të bazuara. Konstatimi pestë (V): OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nga AK, nuk e plotëson kërkesën për dëshminë "Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogarin ose qasje të pakushtëzuar në kredipër realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion euro (min.60% të plotësohet nga lideri në rast të grupit" Me qëllim të sqarimit dhe vërtetimit të gjendjes faktike, eksperti shqyrtues i është drejtuar me kërkesë për sqarim Bankave të cilat kanë lëshuar leter referenca për OE, me pyetje: Pyetje Drejtuar bankës BKT: 1. Limiti i aprovuar për klientin tuaj prej 3,000,000€, deri me 13.02.2024 a ka qenë i shfrytëzuar, dhe nëse po, sa ka qenë shumën e mbetur/në dispozicion me 13.02.2024. 2. Në rast se klienti juaj eventualisht shpallet fitues dhe nënshkruan kontratë për projektin në fjalë, a ofron banka juaj garnacion se klientit tuaj do ti aprovohet kredia dhe nëse po,

deri në çfarë vlere.". Pyetje e drejtuar bankës Raiffeisen : 1. Limiti i aprovuar për klientin tuaj prej 3,400,000€, deri me 15.02.2024 a ka qenë i shfrytëzuar, dhe nëse po, sa ka qenë shumën e mbetur/në dispozicion me 15.02.2024. 2. Në rast se klienti juaj eventualisht shpallet fitues dhe nënshkruan kontratë për projektin në fjalë, a ofron banka juaj garnacion se klientit tuaj do ti aprovohet kredia dhe nëse po, deri në çfarë vlere. Me datë 08.08.2024 kemi pranuar një përgjigje nga banka BKT si në vijim: "Ju njoftojmë se kërkesa juaj është duke u shqyrtuar dhe në afatin sa më të shkurtër kohor do të pranoni përgjigje nga anajonë." Deri në ditën e dorëzimit të këtij raporti me 15.08.2024 eksperti shqyrtues nuk ka pranuar përgjigje konkrete nga bankat përkatëse, andaj vlerësojmë se dëshmia e ofruar nga OE rekomanduar si e tillë nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit, pasi dëshmitë e ofruara nuk vërtetojnë se i njëjti ka para të gatshme në llogari ose qasje të pakushtëzuar në kredi. Konstatimi gjashtë (VI): Në Dosje të Tenderit, Kapaciteti teknik dhe profesional - Kërkesa 4. Staf i profesional - Inxhinierët kërkohet: 1 (një) Inxhinier i elektroteknikës - Tension i lartë dhe 1 (një) Inxhinier i elektroteknikës - Tension i ulët, Diplomat e noterizuara (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master) dhe së paku 5 vite përvojë profesionale. Sa i përket reduktimit të kërkesës nga 2 (dy) inxhinier të elektroteknikës: 1 (një) tension i lartë dhe 1 (një) tension i ulët, më vonë me përgjigje sqaruese dt.05.02.2024 AK zbut kriterin, me reduktim në vetëm 1 (një) inxhinier të elektros. Eksperti shqyrtues/teknik pas ekzaminimit të pretendimeve, konstaton se, bazuar në faktin që AK përmes sqarimeve të ofruara ka reduktuar kërkesën për dy inxhinier të elektroteknikës një tension i lartë dhe një tension i ulët, në vetëm një inxhinier të elektros, kushti për kapacitet teknik dhe profesional është plotësuar. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është i pabazuar. Konstatimi shtatë (VII): Në lidhje me pretendimin e OE ankues, se nuk është plotësuar kërkesa e

dosjes së tenderit për pozicionin 4.1. “Një Menaxher i Projektit - Inxhinier i dip. i Arkitekturës ose Ndërtimtarisë, me përvojë 10 vjeçare profesionale në menaxhimin e projekteve të punimeve ndërtimore (së paku një objekt spitalor)”, nga OE i rekomanduar. Gjegjësisht inxhinieri nuk ka menaxhuar asnjë objekt spitalor sipas kërkesës në dosje të tenderit. OE i rekomanduar ka dëshmuar marrëveshjen kontraktuale dhe diplomën e inxhinierit, si dhe i njëjti në referencat e tij ka qenë pjesëmarrës në pozitën e menaxherit në projektin: Renovimi i ashensorit dhe shkallëve emergjente në Spitalin e Prizrenit, me përshkrimin e punëve të kryera: Ndërtimi i bazamentit për ashensor dhe shkallë emergjente, dhe punë të vogla elektrike, izolimi/fasada Alukobond dhe riparim i çatisë. Meqë nuk është specifikuar ndonjë pozicion i veçantë ose punë specifike në spital sipas kërkesës, punët e realizuara janë punë ndërtimore dhe i njëjti plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është i pabazuar. Konstatimi tetë (VIII): Në Dosje të Tenderit, Kapaciteti teknik dhe profesional - Kërkesa 4. Staf i profesional - Inxhinierët kërkohet “Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon me staf profesional të nevojshëm (min. 10 inxhinierë) për realizimin e projektit”. OE i rekomanduar në shkresën “Lista e stafit me Inxhinier që do jenë pjesë projekti” ka të listuar 9 inxhinier. Numri i reduktuar i Stafit profesional - inxhinierëve, nga 10 (dhjetë) në 9 (nëntë) inxhinier, është bërë pas sqarimeve të AK-së për reduktim të kërkesës nga 2 (dy) inxhinier të elektroteknikës: 1 (një) tension i lartë dhe 1 (një) tension i ulët, me reduktim në vetëm 1 (një) inxhinier të elektros, përmes Sqarimeve të datës 05.02.2024. Me reduktim të kërkesës për 2 (dy) inxhinier të elektroteknikës: 1 (një) tension i lartë dhe 1 (një) tension i ulët, përmes përgjigjeve sqaruese të dt.05.02.2024 AK redukton në vetëm 1 (një) inxhinier, andaj, numri i përgjithshëm i inxhinierëve është reduktuar në 9 (nëntë). Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është i pabazuar. Pas shqyrtimit të pikës ankimore dhe analizës së dosjes së tenderit të OE të rekomanduar nga AK, eksperti shqyrtues/teknik kanë vlerësuar se, sa i përket pretendimeve për stafin udhëheqës (12 udhëheqës) të OE të rekomanduar për kontratë, eksperti teknik/shqyrtues pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar, ka gjetur se: në kuadër të udhëheqësve të pozicioneve, nuk janë plotësuar kushtet e shkollës së mesme si kërkesë e dosjes së tenderit, apo përgatitje profesionale nga trupat e akredituar nga AKK, ndryshuar/plotësuar përmes sqarimeve të ofruara nga AK Për udhëheqësit në pozicione kryesore të punimeve, për Hidroizolues dhe për Montator dyer dhe dritare, OE i rekomanduar nuk ka ofruar dëshmi për kualifikim të këtyre personave në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, më konkretisht nuk kanë Diploma të shkollës së mesme as Certifikata për trajnime nga trupa të akredituara nga AKK. Bazuar në atë që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar. Konstatimi nëntë (XI): Çështja e ngritur në këtë pikë ankimore kundrejt OE-ve të tjerë (që nuk kanë parashtruar ankesë në OSHP) është shumë e përgjithësuar, pa pretendime ankimore konkrete andaj edhe nuk mund të japim përgjigje në këtë pretendim ankimor. Konstatimi dhjetë (X): Sa i përket OE ankues kundrejt OE “Nika Pro-Ing SHPK, Pro-Co Group & Anion Mep Contracting”, Eksperti shqyrtues sqaron se OE “Nika Pro-Ing SHPK”, sipas marrëveshjes për themelimin të koncensiumit nuk është përcaktuar si lider i grupit, poashtu nuk i ka bashkangjitur ankesës Autorizim për parashtrim të ankesës dhe përfaqësim të grupit në OSHP, megjithatë ekspertët shqyrtues me rastin e pranimit të Autorizimit, në kuptim të nenit 114 të LPP-së obligohen të përgjigjen pretendimeve ankimore. Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Nika Pro Ing me Nr. 360/24 Konstatimi parë (I): Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës nr.360/24 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues ku sipas AK-së i njëjti ka mos përputhje mes cmimit total të dhënë në Formular të tenderit dhe cmimit total në paramasë/përshkrim të cmimeve. OE ankues pretendon se arsyetimi i AK-së nuk qendron sepse edhe ne raportin e hapjes kur ishte bere shifet qarte se vlera pa TVSH ishte cmim i ofruar ne rregull mirepo ne llog e Tvsh ishte bere nje gabim, mirepo shifet qarte qe nuk eshte e vertet se ka mos perputhje. Eksperti shqyrtues pas anlizimit të ofertës së OE ankues, gjegjësisht pas analizimit të cmimit total të shënuar tek përshkrimi i cmimeve dhe cmimit total të dhënë në paramasë, kemi gjetuse cmimi total I dhënë tek përshkrimi i cmimeve është 20,310,834.88 €. Ndërsa cmimi totao i dhënë në formular të dorëzimit të tenderit është 80,310,834.88 €. Eksperti shqyretues në rastin konkret vlerëson se nuk kemi të bëjmë me gabim në llogaritje apo aplikim të normës së duhur të TVSH-së, pasi gabimi në nonnë TVSH-së mund të jetë 0 deri 18%, mirëpo kemi të bëjmë me mos përputhje të cmimit total të ofertës të dhënë në formular të tenderit dhe cmimit total në përshkrim të cmimeve. Ky problem është i rregulluar në mënyrë eksplicite përmes Rregullorës për Prokurim Publik 001/2022: Rregullorja për Prokurim Publik 001/2022, neni 40.10 pika (b): b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formidarin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet. Bazuar në të gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar, dhe vendimi i AK-së është marr në pajtim me nenin 40.10 pika (b) të rregullores për propkurim public 001/2022. Konstatimi dytë (II): Lidhur me pretendimin ankimorë dhe arsyen e eliminimit për dokumente të dorëzuara në gjuhë jozyrtare, eksperti shqyrtues i referohet përgjigjes së KRPP-së në pyetjen 10.07.2019. A duhet të refuzohet tenderi apo të kerkohet sqarinie sipas 72, i cili ka sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me LPP? Në fund të përgjigjes së KRPPs-ë shënon : Kështu, duke pasur parasysh konsideratat e lartpërmendura, tenderi i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet. Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument. Bazuar në këto që u cekën si më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar. Konstatimi tretë (III): Eksperti shqyrtues vlerëson se dëshmia e ofruar nga OE i rekomanduar, nuk vërteton se i njëjti ka para të gatshme në bankë apo qasje të pakushtzuar në kredi. Me qëllim të sqarimit dhe vërtetimit të gjendjes faktike, eksperti shqyrtues i është drejtuar me kërkesë për sqarim Bankaëve e cila ka lëshuar leter referenca për OE, me pyetjen : Dretjuar bankës BKT 1. Limiti i aprovuar për klientin tuaj prej 3,000,000€, deri me 13.02.2024 a ka qenë i shfrytëzuar, dhe nëse po, sa ka qenë shuma e mbetur/në dispozicion me 13.02.2024. 2.Në rast se klienti juaj eventualisht shpallet fitues dhe nënshkruan kontratë për projektin në fjalë, a ofron banka juaj garnacion se klientit tuaj do ti aprovohet kredia dhe nëse po, deri në çfarë vlere.”. Pyeja e drejtuar bankës Raiffeisen : 1. Limiti i aprovuar për klientin tuaj prej 3,400,000€, deri me 15.02.2024 a ka qenë i shfrytëzuar, dhe nëse po, sa ka qenë shuma e mbetur/në dispozicion me 15.02.2024. 2. Në rast se klienti juaj eventualisht shpallet fitues dhe nënshkruan kontratë për projektin në fjalë a ofron banka juaj garnacion se klientit tuaj do ti aprovohet kredia dhe nëse po, deri në çfarë vlere. Me datë 08.08.2024 kemi pranuar një përgjigje nga banka BKT si në vijim: “Ju njoftojmë se kërkesa juaj është duke n shqyrtuar dhe në afatin sa më të shkurtër kohor do të

pranoni përgjigje nga ana jonë.”. Deri në ditën e dorëzimit të këtij raporti eksperti shqyrtues nuk ka pranuar përgjigje konkrete nga bankat përkatëse, andaj vlerësojmë se dëshmia e ofruar nga OE ankues si e tillë nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit, pasi dëshmitë e ofruara nuk vërtetojnë se i njëjti ka para të gatshme llogari ose qasje të pakushtëzuar në kredi. Konstatimi i tretë (III): OE ankues pretendon OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm pasi që nuk ka arrit të plotësojë kërkesatë DT. Sipas OE ankues OE (i rekomanduar) nuk ka arrit të përmbush kushtin. Ka ofruar listën me kontrata të cilat shumica prej kontratave të ofruara janë me OE private të cilat nuk i përmbushin kërkesat e DT, pasi nuk i kanë të bashkangjitura qarkullimin bankare, situacionet dhe faturat, ndashtu nuk kanë pranime teknik. Kontrata të cilat janë të lidhura në vitin 2018 deri 2020 nuk mund të llogariten si kontrata të realizuara pasi MSH ka qenë dashtë të bëjë kërkesë për sqarim për vitet 2021,2022,2023 të dihet qarkullimi i sakte bankare dhe i punëve të kryera që të mirren për bazë, Me këto kontrata OE nuk ka arrit të plotësojë kushtin e kërkuar në dosjen e tenderit. Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë eksperti shqyrtues/teknik vlerësojnë se: Lidhur me projektet: Ndërtimi i Stadionit të qytetit në Gjiilan, Faza e parë - Renovimi i stadiumit në Gjakovë, Faza e dytë -Ndërtimi i stadiumit të qytetit Drenas, Ndërtimi i Parkut Industrial në Miradi, ndërtimi i Fakultetit të FSHMN-së - Prishtinë, Ndërtimi i stadioneve ndihmëse në Gjiilan, Pejë, Drenas dhe Studenqan, Furnizimi dhe ekzekutimi i punëve në parkingut në Prishtinë, Ndërtimi dhe furnizimi i ndërtimit në Lagjen Marigona Hill, Furnizimi me beton për ndërtimin e objekteve afaristo-banesore për Pozhegu Brothers. Për të gjitha këto projekte OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar kontratë dhe referenca, të cilat nuk dëshmojnë realizimin/përfundimin e suksesshëm të këtyre projekteve. Përkundrazi në këto referenca shënon “Referencë pozitive ... prej fillimit të kontratës deri më sot...”, “Tealizim i punimeve deri në masën 85%”, “... në punimet që po zhvillohen ...”, “... me sukses e ka përfunduar pjesërisht furnizimin ...”, e të ngjashme. Duke u bazuar në këto konstatime, me të cilat vërtetohen se OE i kontraktuar nuk ka përfunduar në tërësi punët sipas marrëveshjes kontraktuale, pastaj kontrata me vetëm furnizim, si dhe kontrata të kombinuara furnizim dhe punë, rezultojnë që OE i rekomanduar nuk e arrin shumën e kërkuar me dosje të tenderin në vlerën prej 25,000,000.00 euro. OE i rekomanduar nga AK, në listën e projekteve të realizuara ka 25 projekte, ndërsa tek referencat ka 23 sosh, meqë në 2 (dy) prej tyre ka aneksë kontratë. Gjatë elaborimit të tyre është vërejtur: 2 (dy) Referenca (Demolition and Landscaping Central Vaccine dhe Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së) nuk kanë nënshkrim, prej tyre njëra (1) nuk ka çmim të përshkruar (Demolition and Landscaping Central Vaccine) dhe tjetra është realizuar deri në masën 85% (Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së); 1 (një) tjetër është në proces e sipër (Punimet në Parkun Industrial në Drenas); 1 (një) është vetëm furnizim (Furnizimi për ndërtimin e objektit afaristo-banesor të investitorit Pozhegu Brothers). Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, eksperti shqyrtues/teknik vlerësojnë se pretendimet ankimore se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën për punë të ngjashme në vlerë 25.000.0006 janë të bazuara. Konstatimi pestë (V): OE ankues pretendon se OE (i rekomanduar) nuk ka arrit të përmbush kushtin pasi ka ofruar vetëm 9 inxhinier jo IO sa ka qenë kërkesa. OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk ka ofruar një inxhinier të elektros. Kërkesa 4. Staf i profesional – Inxhinierët. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon një staf profesional të nevojshëm (min. 10 inxhinierë) për realizimin e projektit Pas sqarimeve të

ofruara nga AK, është lejuar që të ofrohet vetëm një inxhinier i elektros, andaj OE i rekomanduar plotëson kërkesën e AK-së. Numri i reduktuar i Stafit profesional - inxhinierëve, nga 10 (dhjetë) në 9 (nëntë) inxhinier, është bërë pas sqarimeve të AK-së për reduktim të kërkesës nga 2 (dy) inxhinier të elektroteknikës: 1 (një) tension i lartë dhe 1 (një) tension i ulët, me reduktim në vetëm 1 (një) inxhinier të elektros, përmes Sqarimeve të datës 05.02.2024. Me reduktim të kërkesës për 2 (dy) inxhinier të elektroteknikës: 1 (një) tension i lartë dhe 1 (një) tension i ulët, përmes përgjigjjeve sqaruese të dt.05.02.2024 AK redukton në vetëm 1 (një) inxhinier, andaj, numri i përgjithshëm i inxhinierëve është reduktuar në 9(nëntë) Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, eksperti shqyrtues/teknik vlerësojnë se pretendimi ankimore ne këtë pike është i pabazuar. Konstatimi gjashtë (VI): OE ankues pretendon se gjithashtu nuk është respektuar edhe kritcri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët siç parashihet edhe ne nenin 60 paragrafi 1.1 I LPP-së, sepse e keni rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm. Gjithashtu OE ankues pretendon se AK nuk e ka respektuar edhe nenin 7 te LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i juaj është që ne mos te shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Eksperti shqyrtues vlerëson se këto pretendime të OE ankues janë vetëm pjesërisht të bazuara sa i përket OE të rekomanduar për kontratë, megjithatë pretendimet ankimore për përgjegjshmërinë e vet OE ankues janë të pabazuara. Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Invest Dooel” Nr. 362/24 Konstatimi parë (I): Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 362/24 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk plotëson kërkesën për para të gatshme në bankë ose qasje të pakushtëzuar në kredi në vlerë 4,000,000€. OE ankues pretendon se e plotëson këtë kërkesë bazuar në dëshmitë e ofruar nga tri banka, të cilat dëshmi i ka bashkangjitur kërkesës/ankesës. Pas analizimit të dëshmive të ofruara nga OE vlerësimi i ekspertit është se përveq dëshmisë së ofruar nga banka Sparkasse në vlerë 1,250,000€, dy refemcat tjera nuk dëshmojnë se OE ankues plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Me qëllim të sqarimit dhe vërtetimit të gjendjes faktike, eksperti shqyrtues i është drejtuar me kërkesë për sqarim Bankaëve e cila ka lëshuar leter referenca për OE, me pyejten: Dretjuar bankës i IALBANK “Has the credit line of your client of €2,000,000 already been used, and if so, how much is the remaining/available amount on 13.02.2024.” (Linja kreditore e klientit tuaj prej 2,000,000€ a është shfrytëzuar, dhe nëse po, sa ka qenë vlera/shuma e mbetur me 13.02.2024) Pyetja Dretjuar bankës Stopanska Banka “Has the credit line of your client of €2,000,000 already been used, and if so, how much is the remaining/available amount on 15.02.2024.” (Linja kreditore e klientit tuaj prej 2,000,000€ a është shfrytëzuar, dhe nëse po, sa ka qenë vlera/shuma e mbetur me 15.02.2024) Deri në ditën e dorëzimit të këtij raporti me 15.08.2024 eksperti shqyrtues nuk ka pranuar përgjigje konkrete nga bankat përkatëse, andaj vlerësojmë se dëshmia e

ofruar nga OE ankues si e tillë nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit, pasi dëshmitë e ofruara nuk vërtetojnë se i njëjti ka para të gatshme llogari ose qasje të pakushtëzuar në kredi në vlerë 4,000,000€. Konstatimi dytë (II): Pretendimet ankimore sa i përket stafit të OE ankues, i cili pretendon se dëshmitë për stafin janë ofruar në pajtim me kërkesat e dosjes, eksperti shqyrtues/teknik pas analizimit të ofertës së OE ankues, sqarojnë se dëshmitë e ofruara për një pjesë të stafit përfshirë këtu edhe z.Nuhiu i prezantuar si menaxher i projektit, janë vërtetim i kopjes nga kopja, pasi kontrata origjinale nuk i është prezantuar noterit, dhe si të tilla nuk plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit. Sqarojmë se kërkesa e dosjes ka qenë “kontrata të noterizuara”, dhe kjo kërkesë nuk plotësohet me vërtetim të kopjes nga kopja të kontratës, pa vërtetim të nënshkrimeve të palëve që lidhin kontratë në prani të noterit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se peretendimi ankimorë është i pabazuar. Konstatimi i tretë (III): Pretendimet e OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë janë se i njëjti nuk plotëson kërkesat e dosjes për punë të ngjashme në tri vitet e fundit në vlerë 25,000,000€, eksperti shqyrtues/teknik japin sqarimet si në vijim: “Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 50% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. Së paku në njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X- ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer Xray Automatike, etj.” Lidhur me projektet: Ndërtimi i Stadionit të qytetit në Gjilan, Faza e parë - Renovimi i stadiumit në Gjakovës, Faza e dytë - Ndërtimi i stadiumit të qytetit Drenas, Ndërtimi i Parkut Industrial në Miradi, ndërtimi i Fakultetit të FSHMN-së - Prishtinë, Ndërtimi i stadiumeve ndihmëse në Gjilan, Pejë, Drenas dhe Studenqan, Furnizimi dhe ekzekutimi i punëve në parkingut në Prishtinë, Ndërtimi dhe furnizimi i ndërtimit në Lagjen Marigona Ilill, Furnizimi me beton për ndërtimin e objekteve afaristo-banesore për Pozhegu Brothers. Për të gjitha këto projekte OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar kontratë dhe referenca, të cilat nuk dëshmojnë realizimin/përfundimin e suksesshëm të këtyre projekteve. Përkundrazi në këto referenca shënon “Referencë pozitive ... prej fillimit të kontratë deri më sot...”, “realizim i punimeve deri në masën 85%”, “... në punimet që po zhvillohen ...”, “... me sukses e ka përfunduar pjesërisht furnizimin ...”, e të ngjashme. Duke u bazuar në këto konstatime, me të cilat vërtetohen se OE i kontraktuar nuk ka përfunduar në tërësi punët sipas marrëveshjes kontraktuale, pastaj kontrata me vetëm furnizim, si dhe kontrata të kombinuara furnizim dhe punë, rezulton që OE i rekomanduar nuk e arrin shumën e kërkuar me dosje të tenderin në vlerën prej 25,000,000.00 euro. OE i rekomanduar nga AK, në listën e projekteve të realizuara ka 25 projekte, ndërsa tek referencat ka 23 sosh, meqë në 2 (dy) prej tyre ka aneksë kontratë. Gjatë elaborimit të tyre është vërejtur: 2 (dy) Referenca (Demolation and Landscaping Central Vaccine dhe Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së) nuk kanë nënshkrim, prej tyre njëra (1) nuk ka çmim të përshkruar (Demolation and Landscaping Central Vaccine) dhe tjetra është realizuar deri në masën 85% (Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së); 1 (një) tjetër është në proces e sipër (Punimet në Parkun Industrial në Drenas); 1 (një) është vetëm furnizim (Furnizimi për ndërtimin e objektit afaristo-banesor të investitorit Pozhegu Brothers). Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, eksperti shqyrtues/teknik vlerësojnë se pretendimet ankimore se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën për punë të

ngjashme në vlerë 25.000.000€ janë të bazuara. Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Ada Consulting” Nr. 367/24 Konstatimi parë (I): Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 367/24 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk plotëson kërkesën për para të gatshme ose qasje të pakushtëzuar në kredi në vlerë 4,000,000€. OE Ankues pretendon se: “..Garancioni i ofruar sipas Letër Referencës, shihet qartazi se i njëjtipërbush të gjitha kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe nuk është i kushtëzuar, për arsyet se Procredit Bank, citojmë: “OE Ada Consulting Group SHPK është duke zhvillu biznes me bankën dhe përdor produkte te ndryshme si depozita ne para lë gatshme, transfere e tërheqje kombëtare e ndërkombëtare të parave, dhe produkte e shërbime tjera”. ” fakte këto që dëshmojnë se operatori ekonomik është solvent dhe ka para të gatshme në bankë. Për me tepër konsiderojmë se autoriteti kontraktues ka dështuar që të vlerësoje drejtë gjendjen faktike, kur nuk ka marrë për bazë garancionin që Procredit Bank ka dhënë ne Letër Referencën me nr. prot. OT-02-2081, dt. 06.02.2024, kur ka garantuar, citojmë: “...klienti nuk posedon limit kreditor, rrjedhimisht Procredit Bank do të konsideroj përkrahjen jinianciare deri në 4,000,000.00 EURO, pas analizës të bërë nga analistët tanë të kredive ”, Pra, narracioni i ndërtuar nga autoriteti kontraktues se garancioni i ofruar është i kushtëzuar, është i padrejtë, pasi që kur konstaton se kinse garancioni i ofruar nga banka është me kushtëzimin “nëse e fiton projektin do të shqyrtohet përkrahja”, këtë konstatim e rrëzon ne tërësisht e dytë e fjalisë nëpasuesin 2 të Letër Referencës, e cila tregon në mënyrë të qartë se Ada Consulting Group SHPK “...nuk ka limit kreditor..” Eksperti shqyrtues vlerëson se dëshmia e ofruar nga OE ankues, nuk vërtetohet se i njëjti ka para të gatshme në bankë apo qasje të pakushtëzuar në kredi. Me qëllim të sqarimit dhe vërtetimit të gjendjes faktike, eksperti shqyrtues i është drejtuar me kërkesë për sqarim Bankaës e cila ka lëshuar leter referenca për OE, me pyejeten : “Në rast se klienti juaj eventualisht shpallet fitues dhe nënshkruan kontratë për projektin në jjalë, a ofron banka juaj garnacion se klientit tuaj do ti aprovohet kredia ne shumen 4,000,000€T. Me datë 13.08.2024 në ora 15:47, kemi pranuar përgjigje nga banka përkatëse si në vijim: “ ...Sa iperketpyetjes suaj lidhur me klientin Ada Consulting Group SHPK, me kete email ne ju vertetojme/konfirmojme qe klienti Ada Consulting Group SHPK, ka limit kreditor te aprovuar ne vlere 4,000,000.00 EURO ne ProCredit. Shumen e mjeteve te larcekura/limitin kreditor, klienti rruund ta shjrytezoj per nevoja te biznesit duke perfshire dhe per financim per projektin “Vazhdimi i Ndërtimi - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”, varesisht nga kerkesa e tij... ”. Bazuar në përgjigjen e pranuar nga Procredit Bank me 13.08.2024 mendimi i ekspertit shqyrtues se dëshmia e ofruar nga OE ankues si e tillë plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Bazuar në këto qëu cekën më lart, vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar. Konstatimi dytë (II): Arsyeja e dytë e eliminimit të OE ankues, është se i njëjti “Nuk ka dëshmuar punë te kryera për dyer X- ray Automatike. Lidhur me punimet me X-ray të Klinika e Ortopedisë, për këtë projekt mungon pranimi teknik”. Pas analizimit të ofertës së OE ankues, eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik kanë gjetur se i njëjti ka ofruar dëshmi kontratën me QKUK për vazhdimin e punimeve në klinikën e Ortopedisë, ku sipas raportit për pranim tekiiiiik janë edhe “Dyer Hermetike INOX me veshje Plumbi” mirepo nuk janë të specifikuara Dyer “Xray me hapje automatike”. Pvvrrveq kvvsaj OE ankues ka ofruar vetëm një raport për pranim të pjesëshëm të punëve, i cili raport shënon komisioni gjatë punës ka verifikuar funksionimin e dyerve, instalimeve elcktrike etj...dhe se komisionit ka kërkuar përmirësimin e

vërejtjeve të evidentuara gjatë punës në terren. Eksperti shqyrtës dhe eksperti teknik vlerësojnë se raporti si i tillë nuk është në pajtim me kërkesat e dosjes, megjithatë në rast eventual të rivlerësimit AK mund të kërkoj sqarime shtesë nëse ky projekt ka përfunduar dhe është pranuar në tërësi nga AK-QKUK duke përfshirë edhe “Dyert XRay me hapje automatike”, gjithmonë në pajtim me dispozitat e nenit 72 të LPP-së për dokumente ekzistenca e të cilave në mënyrë objektive mund të vërtëtohet se kanë ekzistuar para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar. Konstatimi tretë (III): Sa i përket arsyes së tretë të eliminimit të OE ankues, mungesa e certifikatës për Ekspertin e sigurisë në punë. Bazuar në dosjen e tenderit të OE - ADA Consulting Group SH.P.K., për pozitën Ekspert për siguri dhe shëndet në punë, ka kontratë me Ahmet Morina, dhe për të njëjtin ka prezantuar Vendim, lëshuar nga MFPT, Nr. Prot. 43011 dt.05.06.2023, në të cilin VENDIM shënon se të njëjtit i aprovet kërkesa për certifikim dhe se certifikata e ekspertit vlen pesë vjet nga data e lëshimit, megjithatë në ofertë mungon Certifikata. Në rast eventual të kthimit të lëndës në rivlerësim vlerësojmë se në pajtim me dispozitat e nenit 72 të LPP-së. mund të kërkoj sqarim/plotësim i dokumentit/certifikatës, nëse dokumenti në fjalë në mënyrë objektive mund të vërtëtohet se ka ekzistuar para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar. Konstatimi katërt (IV): Pretendimi kundrejt OE të rekomanduar për kontratë se 12 punërot (Bajram Kiqina, Tafil Kiqina, Sami Bilalli, Shenjestar Kastrati, Hasan Gashi, Shemi Gllareva, Albert Hoti, Shpend Shala, Asdren Kelmendi, Islam Shala, Bleron Neziri, Florim Berisha) nuk kanë kontrata dhe për Ejub Bërbatovci kontrata e prezantuar nuk është e nënshkruar. Bazuar në dosjen e tenderit të OE të rekomanduar dhe analizave të bëra në këtë pretendim, të gjeturat janë: Sami Bilalli, Hasan Gashi dhe Florim Berisha kanë kontrata me OE, ndërsa Ejup Bërbatovci ka kontratë të cilës i mungon faqja e fundit e nënshkrimit të kontratës, ndërsa për personat e tjerë të lartcekur OE nuk ka prezantuar fare kontrata. Sipas vlerësimit të ekspertëve nga 59 punëtorët e prezantuar në listën e punëtorëve, njërit punëtor në kontratë i mungon faqja e fundit dhe 9 tjerë nuk kanë kontrata fare, njëdhimisht rezulton që OE rekomanduar ka ofruar dëshmi për 49 nga minimumi i 50 punëtorëve të kërkuar. Duke u bazuar në kushtet e kërkesës nga 50 punëtorë - staf teknik, në kuadër të secilit pozicion/grup një udhëheqës gjegjësisht 12 udhëheqës, OE i rekomanduar ka plotësuar numrin e përgjithshëm të punëtorëve (59 punëtor teknik dhe 12 udhëheqës në pozicione). Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar. Konstatimi i pestë (V): Sa i përket pretendimeve për statfin udhëheqës të OE të rekomanduar për kontratë, eksperti teknik/shqyrtues pas analizimit të ofertës së OE ka gjetur të gjithë udhëheqësit (12) kanë prezantuar kontrata të noterizuara dhe të gjithë kanë diplomë të shkollës së mesme (diplomë të nivelit bachelor) ose trajnim në fushën përkatëse. Avdyll Morina, Egzon Hoti, Besart Gashi kanë prezantuar Diploma të nivelit bachelor, jo vetëm që I kanë plotësuar kushtet, por janë të mbikualifikuar për pozitën. Fetah Meleqi ka prezantuar diplomë të shkollës së mesme. Në kuadër të udhëheqësve të pozicioneve, nuk janë plotësuar kushtet e shkollës së mesme si kërkesë e dosjes së tenderit, apo përgatitje profesionale nga trupat e akredituar nga AKK, ndryshuar/plotësuar përmes sqarimeve të ofruara nga AK Për udhëheqësit në pozicione kryesore të punimeve, për Hidroizolues z.Gashi dhe për Montator dyer dhe dritare z.Elezi, OE i rekomanduar nuk ka ofruar dëshmi për

kualifikim të këtyre personave në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, më konkretisht nuk kanë Diploma të shkollës së mesme as Certifikata për trajnime nga trupa të akredituara nga AKK. Bazuar në këto që u cekën më lart eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik vlerësojnë se kërkesa diplomë/nivel të shkollimit apo përgatitja profesionale nga Trupa të akredituara nga AKK nuk mund të zëvendësohet me certifikatë/trajnime ose kurse një ditore. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar. Konstatimi gjashtë (VI): Pretendimi ankimorë se në CV-në e Muhadin Morina nënshkrimi është elektronik dhe i manipuluar. Pretendime ankimore për manipulim të nënshkrimeve konsiderojmë që janë jashtë përgjegjësisë, autorizimit dhe kompetencës së ekspertëve shqyrtues/teknik. Konstatimi shtatë (VII): OE ankues pretendon se lidhur me dëshmitë e dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate (BM Group SHPK). “BM Group” SHPK, në pozitën e Ekspert i Sigurisë, ka prezantuar z.Muhamet Hamiti, i cili posedon një certifikatë të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila është lëshuar me datë 17.05.2017, Por, duke pasur parasysh kornizën ligjore respektivisht nenin 12 par 3 të Rregullores Nr.01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, i cili përcakton se: “3. Certifikata e Eksperti vlen pesë (5) vjet nga data e lëshimit.”, rezulton se e njëjta është e skaduar dhe jo valide Në vendimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 16.04.2024, autoriteti kontraktues thotë “...certifikata në fjale është lëshuar me 17.05.2017 nga Ministria e Punës dhe mirëqenies Sociale dhe nuk ka datë skadimi, andaj për ne është e pranueshme duke marrë parasysh se është lëshuar nga Institucioni Shtetëror i RK dhe është dokument i noterizuar”. Por autoriteti kontraktues nuk e trajton njëjtë dhe barabartë sipas parimeve të prokurimit edhe vendimi për certifikim që kemi prezantuar në është lëshuar nga po i njëjti institucion dhe sipas rregullores për certifikim (rregullore e po këtij institucioni) certifikata është valide 5 vite. Si rrjedhojë e këtyre mungesave, operatori ekonomik BM Group SHPK konsiderohet se nuk ka plotësuar dorëzuar dëshmitë lidhur me këtë kërkesë dhe se autoriteti kontraktues ka përdorur parime të dyfishta në raport me kërkesat e njëjta ndaj operatoreve ekonomik të ndryshëm, duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-se. Eksperti shqyrtues/teknik vlerësojnë se bazuar në dokumentacionin e bashkëngjitur në ofertë, i kontraktuari Muhamet Hamiti për pozitën Ekspert për siguri dhe shëndet në punë, konfirmohet se ka prezantuar Certifikatë të lëshuar nga MPMS të datës 17/05/2017. Bazuar në Rregulloren (MPMS) Nr. 01/2021, neni 12, paragrafi 3. citoj “Certifikata e Ekspertit vlen pesë (5) vjet nga data e lëshimit”, pastaj në paragrafin 4. Certifikata e Ekspertit përmban: nënparagrafi 4.5. citoj “Peridhën e validitetit të Certifikatës së Ekspertit”. Meqë Certifikata e Ekspertit Muhamet Hamiti është lëshuar në vitin 2017 dhe nuk përmban datë të skadimit, ndërsa rregullorja nr.01/2021 e cila afatizon certifikatat për siguri në punë në 5 vite është nxjerr në vitin 2021, vlerësimi i ekspertit shqyrtues është se certifikata e z.Hamiti është e pranueshme përderisa nuk ka datë të skadimit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar. Konstatimi tetë (VIII): Pretendimi ankimor se OE i rekomanduar ka fruar garancionin 7 vite pas fdlimit të punëve, ndërsa sipas sqarimeve të AK-së duhet të jepet garancioni “vite nga data e pranimit teknik”, eksperti shqyrtues vlerëson se AK pas sqarimeve të dhëna, nuk ka bërë njoftim për korrigjim dosjes, e po ashtu nuk ka bërë ndryshim të vet dosjes së tenderit. Me qenë se kërkesa në dosej të tenderit dallon nga sqarimet e dhëna, në

mungesë të dispozitave të përshtatshme të LPP-së për kërkesa të paqarta të dosjes, eksperti shqyrtues bazuar në parimet e ligjit të mardhënieve dhe detyrimeve nën 86 Dispozitat e paqarta në rast të veçanta, “Vë rastin kur kontrata është lidhur sipas përmbajtjes së shtypur çj më parë, ose kur kontrata ka qenë në nclonjë niënyrë e përgatitur dhe e propozuar ngct njëra palë kontraktuese, dispozitat e paqarta do të inteipretohën në dobi të palës tjetër”. Andaj vlersojmë se edhe kërkesat e dosjes të ndryshuara përmes “s qarimeve” të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e dosejs, duhet të inteipretohët në dëm të hartuesit të dosjes, gjegjësisht në dëm të Autoritetit kontraktues dhe në dobi të OE-ve ofertues. Bazuar në gjitha këto të cekura më lart vlerësojm se pretendimi ankimor është i pabazuar. Konstatimi nëntë (IX): “Operatori ekonomik cluhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte te ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë. Ne rast te konsorciumit, së paku 50% e punëve te përfunduara kërkohet për liderin e grupit. Së paku në njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X- ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer Xray Automatike, etj.” Lidhur me projektet: Ndërtimi i Stadionit të qytetit në Gjiilan, Faza e parë - Renovimi i stadiumit në Gjakovës, Faza e dytc - Ndërtimi i stadiumit të qytetit Drenas, Ndërtimi i Parkut Industrial në Miradi, ndërtimi i Fakultetit të FSHMN-së - Prishtinë, Ndërtimi i stadiumeve ndihmëse në Gjiilan, Pejë, Drenas dhe Studenqan, Fumizimi dhe ekzekutimi i punëve në parkingut nc Prishtinë, Ndërtimi dhe fumizimi I ndërtimit në Lagjen Marigona Hill, Furnizimi me beton për ndërtimin e objekteve afaristo-banesore për Pozhegu Brothers. Për të gjitha këto projekte OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar kontratë dhe referenca, të cilat nuk dëshmojnë realizimin/përfundimin c suksesshëm të këtyre projekteve. Përkundrazi në këto referenca shënon “Referencë pozitive ... prej fillimit të kontratë deri më sot...”, “realizim i punimeve deri në masën 85%”, “... në punimet që po zhvillohen ...”, “... me sukses e ka përfunduar pjesërisht fumizimin ...”, e të ngjashme. Duke u bazuar në këto konstatime, me të cilat vërtetohen se OE i kontraktuar nuk ka përfunduar në tërësi punët sipas marrëveshjes kontraktuale, pastaj kontrata me vetëm fumizim, si dhe kontrata të kombinuara fumizim dhe punë, rezulton që OE I rekomanduar nuk e arrin shumën e kërkuar me dosje të tenderin në vlerën prej 25,000,000.00 euro. OE i rekomanduar nga AK, në listën e projekteve të realizuara ka 25 projekte, ndërsa tek referencat ka 23 sosh, meqë në 2 (dy) prej tyre ka aneksë kontrata. Gjatë elaborimit të tyre është vërejtur: 2 (dy) Refercna (Demolation and Landscaping Central Vaccine dhe Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së) nuk kanë nënshkrim, prej tyre njëra (1) nuk ka çmim të përshkruar (Demolation and Landscaping Central Vaccine) dhe tjetra është realizuar deri në masën 85% (Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së); 1 (një) tjetër është në proces e sipër (Punimet në Parkun Industrial në Drenas); 1 (një) është vetëm furnizim (Furnizimi për ndërtimin e objektit afaristo-banesor të investitorit Pozhegu Brothers). Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, eksperti shqyrtues/tcknik vlerësojnë se pretendimet ankimore se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën për punë të ngjashme në vlerë 25.000.000E janë të bazuara. Konstatimi i dhjetë (X): Pretendimi ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofrua dëshmi për një projekt që përshinë Dyert automatike XRay, gaz medicinal etj, pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë kemi gjetur se ky OE ka ofruar dëshmi për këtë kërkesë përmes kontratës dhe referencës me UNOPS për Rehabilitimin e Klinikës së Radiologjisë në Ferizaj,

konkretisht në kapitullin Annex A - Bill of Quantity (Bill 2), andaj vlerësojmë se ky peretendim është i pabazuar.

Paneli Shqyrtues pasi analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër ka konstatuar se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se është e nevojshme të mbahet seanca dëgjimore (e mbajtur me datën: 27.08.2024), me palë sikurse parashihet në Rregulloren e Punës së OSHP-së.

Në seance degjimore të mbajtur me datë: 27.08.2024, pas prezantimit në séance paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet për séance dhe njëherit kryesesi i seances pasi njoftimit të dhënë për të pranishmit, konkretisht objektit të shqyrtimit në seance degjimore vazhdoj duke i dhënë përfaqesit të OE Mabco Constructions, me nr: 2024/0352, z. Bibaj i cili deklaroj: Grupi i OE-ve, pas analizimit të raportit të eksperteve të autorizuar, në si OE e kemi kundërshtuar sipas përgjigjes në raport edhe tani vazhdojmë ta kundërshtojmë propozimin e eksperteve për mbetjen në fuqi të vendimit të AK-se. Arsyeja e vetme të eksperteve për lënien në fuqi të vendimit të AK-se, ka të bëjë me qeshtjen e planit dinamik ku të njëjtit në raportin e tyre kanë konstatuar se nuk është dërguar sipas formës standarde të aplikuar nga AK-ja, dhe nuk i përmban ditët apo periudhën kohore të realizimit të projektit. Sipas raportit ekspertët potencojnë se formati PDF, nuk i përmban të gjitha të dhënat dhe këto çështje nuk e kanë bazuar në ndonjë rregull ligjore, kërkesë kualifikuese të përcaktuar në FDT, por vetëm nga aspekti profesional. Me ligje dhe rregulla të ndërtimit ekzistojnë dy lloje të planit dinamik, gentogrami dhe plani vjetor. Kompania Mabco Constructions në ofertë ka prezantuar planin dinamik të detajuar i cili i përmban të gjithë periudhën e dinamikës së punëve, përmban edhe periudhën kohore ku në të njëjtin plan është përcaktuar edhe dita e përfundimit ku gjithësej janë përcaktuar 652 ditë. Si prova e prezantimit për panelin, planin dinamik, përveç kësaj AK – MSH, planin dinamik e ka kërkuar të aneksi 1 i DT-se, ku është përcaktuar që i njëjti plan duhet të jetë konform normave dhe standardeve ndërtimore, ku në si OE e kemi dorëzuar planin që i përmban të gjitha normat dhe standarde. Pra plani nuk është aplikuar të kërkesat kualifikuese por tek aneksi 1 - të specifikimet teknike. Përveç kësaj konsiderojmë se AK-ja, apo edhe ekspertët shqyrtues, për çështjet e planit dhe ndonjë paqartësi të saj, për hir të parimeve të prokurimit publik, kanë mundur të kërkojnë sqarim e shtesë sipas nenit 72 dhe 59 të LPP-se. Prandaj, në kërkojmë që PSH-ja, me rastin e vendimmarrjes të aprovojë në tërësi ankesën tonë dhe të obligojë AK-MSH-në të bëjë rivlerësimin e ofertave.

Në vazhdim, fjala iu dha përfaqësuesit të AK – së z. Berat Mermullaku, i cili deklaroj: sa i përket ankesës së OE Mabco Constructions, e gjithë poenta këtu është të plani dinamik i OE ankues, plani dinamik, i ofruar në këto oferta nuk është pranuar duke marrë parasysh se në DT është kërkuar që OE-të duhet të dorëzojnë planin dinamik të detajuar siç është dokumenti i dosjes së tenderit. Ka lloj lloj plane dinamike dhe jo vetëm ato që i deklaroj përfaqësuesi i OE ankues, dhe nëse fundmi i kemi krijuar një plan dinamik në bashkëpunim me USIAD-in, pra është dashur të dorëzojnë standardin e aprovuar nga ne, planin dinamik OE ankues e ka dorëzuar me mangësi të

shumta, ku ka pozicione te pa pakuptimta. Pra nuk eshte plotësuar plani dinamik i kërkuar ne DT.

Në vazhdim fjalën iu dha edhe ekspertit Teknik z. Liridon Gashi i cili deklaroi: ne Kosove nuk ka legjislacion qe e rregullon planin dinamik dhe nuk ka form qe e rregullon planin dinamik. Sa i përket planin dinaik qe e ka dorëzuar OE Mabco Constructions nuk eshte sipas kërkesës se AK-se. Si total nuk eshte me përmbajten e plote sic e cekti edhe perfaqesuesi i AK-se, dmth, janë pozicione nga dita e pare deri ne ditën e fundit. Pjesa tjerët per secilin pozicion qe eshte ne faqen 2, mungon te OE-ja dhe si e tille eshte dashur ti përmbahet planit prej 360 dite. Andaj une si ekspert qëndrojmë prapa raportit te dhene nr. 352/24.

Perfaqesuesi i OE ankues Mabco Constructions, deklaroi: me nenin 44 te Rregullores per Prokurim Publik me nr: 001/2022, format standarde kan te bëjnë vetëm me ate qe OE-ve, te ju mundësohet ose te ken me te qart aplikimin e nje kerkese por asesi nuk kan te bëjnë me plotësim te kërkesës kualifikuese. Ne kete rast e përmendi edhe perf. i AK-se, se ka qene kerkese e aneksit 1, perveq kësaj per ankesën ton janë realizu dy raporte te ekspertizës dhe ne raportin e pare, eksperti shqyrtues, ka vleresuar se nëse OE nuk aplikon form standarde te AK-se, nuk ekziston baze ligjore per te eliminuar ofertën e tij. Cdo respekt per ekspertin qe eshte këtu, por ne sipas qasjes se liste te ekseperteve eshte Inxhinier i arkitekturës, dhe plani do te duhej te analizohej nga Inxhinier i ndërtimtarisë me kualifikim konstruktiv dhe jo arkitekture.

Në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE ankues Nika Pro ing, me nr: 2024/0360, z. Musa i cili deklaroi: ne njoftimin per kontrate te AK-se, ne qasje te dokumentacionit te ofertave konkurruese, kemi verejtur se OE i rekomanduar per kotnrate, eshte i papërgjegjshëm dhe per kete arsye kemi bere kerkese per rishqyrtim dhe ankese ne OSHP. Ne pajtohemi pjesërisht me eksperizen e fundit ku per pretendimin nr:1 nuk pajtohemi pasi qe janë thirrur ne nje nen te LPP-se dhe rregulloren e KRPP-se, qe kinse ne kemi gabim ne formularin e tenderit te dorëzuar. Shihet qart edhe ne procesin e hapjes, se vlere pa TVSH, eshte e shenuar mire, ndersa te çmimi i pershkruar me TVSH, eshte bere nje gabim teknik nga nr. 2 ne 8. Kete devijim te vogël e lejon neni 59.4 i LPP-se, dhe neni 45.19 dhe 20 i Rregullores. Rrjedhimisht ne nuk mund te eliminohej per shkak te këtij devijimi te vogël, pasi qe ne formmlarin e dorëzimit dihet qe kjo procedur ka qene ekonomikisht me i favorshëm dhe te nen kriteret ne e kemi shënuar çmimin pa gabime. Në pretendimin e dyte pajtohemi me konstatimin e eksperteve pasi qe AK-ja ka mundësi te kerkoje sqarim per dokumentet e dorëzuar ne gjuhen arabe. Ne pretendimin e trete, nuk pajohem me ekspertet pasi qe nuk kan arritur te japin nje konkluzion lidhur me mbeshtjen bankare, pasi qe pretendimi jone ka qene i qart se OE i rekomanduar per kotnrate nuk e plotëson kete kerkese te AK-se. Ne pretendimin e 4-te, ne pajtohemi me mendimin e eksperteve qe konstatojn se pretendimi jone ankimore per qarkullimin e OE te rekomanduar per kontrate, nuk e plotëson kërkesën e AK-se. Mirëpo kjo bie ndesh me konkluzionin e tyre ne fund qe e sugjerojnë te mbetet vendimi i AK-se ne fuqi. Ne momentin e aprovimit te pretendimit tone qe eshte i bazuar ekspertet eshte dashur ta shpallin te papërgjegjshme OE te rekomanduar per kontrate.

Në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të AK –së z. Berat Mermullaku, i cili deklaroj: kjo ofertë është eliminuar, i cili ka gabuar në çmimin total të ofertës dhe ka diskrepancë të madhe në mes të çmimit nga formulari i platformës së e-prokurimit dhe çmimit të ofertës së dorëzuar dhe kjo është rregulluar me rregulloren nëni 40.10 paragrafi B specifikon: në rast se ka mospërputhje në mes të çmimit total të tenderit dhe totalit të përshkrimit të çmimit oferta refuzohet dhe në këtë rast oferta e OE ankues Nika Pro Ing, në formular është 80 milion euro ndërsa në përshkrim të çmimit është 20 milion euro.

Poashtu ka dorëzuar dokumente në gjuhën arabe por çështja e çmimit është bazike.

Përfaqësuesi i Nika Pro Ing, deklaroj se nuk pajtohem me deklarinimin e përfaqësuesit të AK-së, pasi çmimi i dhënë në hapjen e tenderit pa TVSH është në rregull, pasi çmimi në formularin e tenderit të kriteri ekonomikisht më i favorshëm dhe rrjedhimisht është gabim teknik dhe nuk duhet të thirret në atë nën që deklaroj.

Në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së së ankues AK Invest Dooel, me nr: 2024/0362 - z. Fazliu i cili deklaroj: Mbesim në tërësi pran ankësës për këto aktivitete të prokurimit, konfirmoj se kemi pranuar ekspertizën e eksperteve dhe vlerësojmë se kjo ekspertizë është në kundërshtim me të gjeturat pasi që njëri anë e aprovojnë si të bazuar ankesën, ndërsa në anën tjetër e len në fuqi vendimin e AK-së, kjo për faktin se OE nuk e ka verifikuar gjendjen financiare të kompanisë dhe kjo bie ndesh me vetëkomunikimet që i kanë pasur me bankën që kanë garatuar për këto projekt, ekspertët shqyrtues raportin zyrtar të ekspertizës e kanë dorëzuar me datën: 15.08.2024, deri sa konfirmimin nga banka Stopanska Banka, e kanë pranuar me datën poashtu 15.08.2024, e që këto komunikime nuk e kanë trajtuar fare nuk e kanë bërë pjesë të ekspertizës dhe poashtu nuk kanë kërkuar sqarim e edhe nga bankat tjera të cilat kanë ofruar mbështetje financiare.

Sa i përket pretendimit të dytë lidhur me kontratat e noterizuar ekspertët, sipas mendimit tonë kanë bërë tejkalim të kompetencave për faktin se OE ankues, ka ofruar dokumente të noterizuara në përputhje me DT dhe në rastin konkret ekspertët kanë aplikuar standarde të dyfishta në disa raste i kanë sugjeruar AK-së të kërkojnë sqarime shtesë, ndërsa në rastin tonë nuk i kanë rekomanduar që AK-ja këto të bejë vetë në përputhje me nenin 72 të LPP-së. Ekspertët shqyrtues nuk i kanë trajtuar fare pretendimit për stafin teknik e që sipas kërkesës së DT-së ka qene që 20 prej tyre të jenë të certifikuar e që këto kritere nuk janë plotësuar nga OE i propozuar për kontratë, mbi të gjitha kërkojmë që OSHP-ja mos të falë besimin kësaj eksperteze, ndërsa mbesim pran pretendimeve të dhëna në ankësën e dorëzuar.

Në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të AK –së z. Berat Mermullaku, i cili deklaroj: si AK, qëndrojmë prapa vendimit tonë, që oferta e këtij OE ankues AK Invest Dooel, është i papërgjegjshëm dhe pajtohem me raportin e eksperteve. Të gjitha kontratat e noterizuar të stafit janë: dokumenti i cili ka një fletë dhe një faqe, përputhet në çdo aspekt me kopjen e zakonshme me parë se me dokumentin origjinal, origjinali i cili nuk më është prezantuar. Pala deklaroi se origjinalin nuk e posedon më vetë, nderkohe që nëse bëjmë një krahasim me ofertën e të

rekomanduairit per kontrate noterizimet e kontratave te inxhinierve janë ne prezantcen e palëve dhe pronarit. Gjithashtu OE ankues eshte eliminuar edhe per mbeshjtjen bankare per te cilën pajtohem.

Në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së se ankues AK Invest Dooel” - z. Fazliu, sa i perket letrës - mbeshitetjes bankare, ne kemi ofruar nga tri banka leter mbeshitetje, kta na kan refuzuar per garancion bankar, dhe banka i pergjigjet ne kerkese te pare. AK-ja, ka kërkuar te kerksa per mbeshitetje financiare, ka kërkuar kapital financiar, mjete te gatshme ne bank, ose mbeshitetje bankare ne kredi. Ndersa ne refuzim jan thirr vetëm te letër mbeshitja per kredi te pa kushtëzuar. Ne rastin konkret kërkesa nuk eshte ne përputhje. Përkundër kësaj ne kemi ofruar letër nga tri banka Hala bank, Shpakase dhe Stopanska Banka, poashtu per shkak se vet AK-ja ka kerkuar mjete te gatshme ne bank, nëse analizohen edhe pasqyrat financiare te audituara shihet se janë mjetet financiare mbi 1.9 milion euro per veq vlerës se lëshuar nga tri bankat tjera, qe ne total eshte mbi 5 milion. Perveq kësaj këto jan tri dëshmi qe i kemi dorezuar ne ofert, te cilat me date 15.08.2024 jan konfirmuar per ekspertet shqyrtues. Sa i përket pretendimit te dyte per kontratat e noterizuara AK-ja ne NJK dhe DT, ka kërkuar kontrate te noterizuar, ndersa ne eliminim thirret pse eshte noterizuar dokumenti nga kopja dhe me kete rast mendojmë se AK-ja po i tejkalon kompetencat perderisa eshte noterizuar nga nje zyre e noterisë ai konsiderohet valid. Ndersa me ekspertizën nuk pajtohen per shkak se tri pretendimet nuk i ka trajtuar fare.

Në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE ankues Ada Consulting Group, me nr: 2024/0367, z. Salihu cili deklaroi: Un konsideroj dhe mbesim ne tërësi pran pretendimeve tona ankimore te ushtruara kundër vendimit te AK-se, ndërkaq pasi qe kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues, te njetin e kemi analizuar me kujdes dhe sa i përket pretendimit nr. 1, 5 dhe 9 si dhe sa i përket perfundimit qe eshte kërkuar te anulohet vendimi per dhenie dhe te kthehet ne rivlerësim jemi pajtuar me rivlerësim. Ndersa sa i perket pretendimit 2,3,4,6,7 te cialt janë aprovuar disa pjesërisht dhe disa janë refuzuar konsiderojmë se ekspertet shqyrtues nuk kan vlerësuar drejte gjendjen faktke me rastin e tratjtitimit te pretendimeve tona por edhe te provave qe jan te bashkangjitura ne dosje, te pretendimi nr 2 konsiderojm se konstatimi i ekspertit dhe AK-se, nuk ka marr per baze prova te cilat si OE i kemi dorëzuar si dhe nuk ka marr fare per baze komunikimi ne mes te AK-se, dhe OE lidhur me punët e kryera sa i perket kerkeses se FDT-se per kontrata X- Ray - dyer automatike, pse e themi kete sepse ne dosjen e OE ka qene e qartësuar ne menyre te detajuar qe projekti i ndërtimit te ortopedisë eshte ndare ne dy faza me vet kerkesen e AK-se dhe planin e menagjimit te kontratës, ku kriteri i kërkuar ne DT, ka qene i përmbushur dhe i përfunduar ne pjesën e pranimit te pjesërisht teknik dhe ajo cka ne konsiderojm qe as AK-ja dhe as eksperti nuk kan marr per baze se pranimi i pjeserishem teknik eshte bere mbi bazën e kërkesës se AK-se, me qellim te lëshimit te objektit dhe funksionalizimit te tij per nevojat e tyre andaj konsiderojmë qe ky pretendimi i yni nga PSH-ja duhet te aprovohet ne tërësi si i bazuar dhe ne kemi edhe prova shtese, sic eshte pranimi i pjeshsem teknik, plani i menaxhimit, DUD-in e dyerve X-Ray dhe vizamitin e objektit te cilat deshmojn se kriteri eshte plotesuar ne tërësi.

Sa i përket konstaitmit te eksperteve per pretendimin nr. 3 konsiderojm se vendimi i Ministrise se Financave, eshte nje akt administrativ i cili e vërteton faktin se z. Ahmet Morina ka qene i

licencuar per kryerjen e punëve si ekspert i sigurisë dhe shendetit ne pune. Çështja e pajisjes se certifikate, eshte nje ceshje teper procedurale per te cilën OE ankues por edhe eksperti i sigurisë ka tentuar disa here te pajiset mirëpo, nuk ka marr asnjëherë përgjigje nga autoriteti qe e ka per obligim ta lëshoj kete certifikat dhe realisht nga informatat qe posedojmë qe asnjë certifikat nga vitit 2021 nga hyrja ne fuqi, nuk eshte nënshkruar asnjë nga ministri. Andaj konsiderojmë se edhe AK-ja, por edhe eksperti ku pjesërisht e aprovon ne kete pike do te duhej te kishin parasysh këto dispozita ligjore dhe praktiken si dhe pa fajin e OE dhe pa fajin e ekspertit ka mberur qe mos pajiset me ate certifikate përkundër faktit qe ka nje vendim te Autoritetit i cili eshte nje akt qe e vërteton se i njëjti eshte i licencuar si ekspert i sigurisë dhe shendetit ne pune.

Sa i përket pretendimit nr 4 konsiderojme se ne raportin e ekspertizes edhe vete ekspertet kan nje kontradikt kur bëjnë vlerësimin dhe kur thon se nr 50 i kërkuar nje nuk e ka fleten e fundit te kontratës dhe 9 te tjere nuk kan kontrata fare, rrjedhimisht OE i rekomanduar per kontrate i ka ofruar 49 nga minimumi i kërkuar. Sa i përket pretendimit nr. 6 mendojme qe dyshimi i ngritur per certifikatën do te duhej te trajtohej ne baze ligjit per shkak se kur ka dyshime se eshte i manipuluar apo i falsifikuar ligji e përcakton se si duhet trajtuar. Tek, pretendimi nr. 7 lidhur me konstatimin e ekspertit se certifikatat per ekspertin e OE te rekomadnaur per kotnrata janë lëshuar ne vitin 2017 ndersa rregullorja ka hyr ne fuqi ne vitin 2021 konsiderojm se eshte nje konstatim duke mos trajtuar sakt gjendjen faktike, neni 37 paragarfi 1 i rregullores i cili përcakton se validiteit i certifikatave te lëshuara para hyrjes ne fuqi eshte varësisht nga lloji i certifikates e qe ne rastin konkret certifikata e eksperteve per siguri ne pune e leshuar nga MPMS, eshte valide 2 vite nga hyrja ne fuqi e kësaj rregullore. Sa i përket pretendimit 8 qendrojm ne tërësi eshte pran anekses qe e kemi dorëzuar, por konsiderojm se konstatimi i dhene nga ekseptri eshte ne kundërshtim me dy momentume juridike. E para ka te beje me ate qe pavarësisht se eksperti qe e ka konstatuar qe nuk ka dispozita qe mund te zbatohen ne kete rast, ne mendojmë qe ne nje rast te till kur ndryshimet behen nga AK-ja, OE-te jan te obliguar qe formën e kërkuar sipas kriterit 6.1 ta plotesojn ashtu sic eshte kërkuar ne ate ndryshim. Eshte sinjifikative se lidhur me kete kriter i vetmi OE qe e ka përmbushur formën ashtu sic e ka kërkuar AK-ja eshte ACG-ja, ndersa 7 OE-te tjetër kan dështuar qe ta përmbushin formn e kërkuar nga AK-ja, madje edhe vet AK-ja ne vendimin e tij per refuzim te kerkese per rishqyrtim ka konstatuar se pretendimi yne rreth kesaj çështje eshte pjeserisht i bazuar, mirëpo e ka refuzuar me arsyetimin se eshte devijim i vogël. Sa i përket konstatimit duhet aplikohet neni 86 i LMD-se, konsiderojm se këtu ka nje huqje te zbatimit te se drejtës material per shkak se neni 86 i LMD-se, flet per rastet kur kontrata eshte e lidhur ose kur kontrata ka qene ne nje menyre e propozuar nga njëra pal kontraktuese e qe ne kete rast nuk mund te zbatohet sepse nuk kemi kontrata qe eshte e lidhur dhe as te pergaditur ne kete faze te procedurës. Nese eshte dashur te merren dispozitat e LMD-se, kerkoje nga PSH-ja qe ti aplikojte dipozitat e nenit 24 te LMD-se paragrafi 1 dhe 2 neni 214 paragrafi 2 te LMD-se si dhe nenit 620 te LMD-se te cilat dispozita flasin per njoftime shpallje oferta dhe ftesa ne marrëdhëniet kontraktuale ne mes te palëve kontraktuese. Andaj këto dispozita ne rast te mungesës sic e ka konstuar ekspertin janë dispozita qe i pershtaten ne menyre te plote procesit lidhur me trajtimin e shklejes qe AK-ja ka bere me rastin e refuzimit te pretendimit lidhur me mos plotësimin e formularit sic eshte kërkuar nga AK-ja, me

plotësimet e dates: 05.02.2024, madje ne kete plotesim AK-ja, ju kishte kërkuar OE-ve qe gjate pergaditje se ofertës se tyre tu përmbahen sqarimeve dhe ne te kundërtën do te refuzohen, andaj konsiderojm qe pas vlerësimit dhe analizimit me kujdes te këtyre pretendimeve tona, PSH-ja do te vërtetoj se vendimi i AK-se eshte vendim i paligjshëm dhe i njëjti duhet te anulohet dhe aktiviteti te kthehet ne rivlerësim.

Në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të AK-së z. Berat Mermullaku, i cili deklaroi se perfaqesuesi i OE ankues shtoj shume çështje, sa i përket OE ACG, ne vendimin tone per eliminim i kemi cek tri arsye, e para qe ka qene kryesorja nuk i eshte pranuar si leter reference nga banka per ta plotësuar kriterin e mbeshjtes bankare qe eshte kerkuar ne DT, kjo pik eshte trajtuar edhe prej ekserteve dhe e kundërshtojmë sepse ata janë bazuar tek konfirmimi i dhene nga banka, nderkohe qe vet ekspertet ne ekspertiz ne faqe 30, citojm: deshmija e ofruar nga OE ankues nuk vërteton se ka para te gatshme apo qasje te pakushtezuar ne kredi, megjithate i eshte drejtuar bankës per sqarime sic e kan potencuar me qellim te sqarimit dhe vërtetimit te gjendjes faktike, me pyetjen: ne rast se klienti juaj shpallet fitues dhe nënshkruhet kontrata, a ofron banka juaj garancionin sipas kerkese se DT-se. OE ne fazën e tenderimit ka kërkuar shume sqarime dhe i kemi ofruar sqarime dhe si rezullatat shume kriteret jan zbutur per shkak te kërkesave te këtij OE, ndersa nuk ka bere pyetje sqaruese per mbeshjetjen bankare e cila eshte kërkuar te jet e pakushtëzuar. Andaj si te tille, AK-ja e vlerëson se nuk e plotëson kete mbeshjetjen bankare te pakushtëzuar, meqenëse ne letrën e referencës se procredit bank, ceket qe nëse klineti e fiton projektin banka do te beje analiz financiare dhe do te vendos. Ndersa sa i përket pjesës tjetër per dyer x-ray automatike OE ankues, e ka prezantuar per kete pike kontaten per kliniken e ortopedisë, ne si AK, i kemi pasur dy inxhinier nga klinika pikërisht nga QKUK-ja dhe kan qene ne dijeni per punet e kryera dhe ata e kan kontestuar se nuk janë me hapje dhe pastaj ka qene edhe çështja e pranimit teknik. Ndersa sa i përket pretendimeve rreth ofertës se OE te rekomanduar per kontrate, dhe shumica nuk ka shume logjik, psh: te pjesa e udheheqesve kur i kemi kërkuar 50 punetore ne DT, e kemi specifikuar qe prej tyre 12 te jen udhëheqës te profileve teknike. Per kete çështje eshte sqarua edhe me sqarimet shtese ne fazën e tenderimit ku per këta 12 udheheqesa te jen me shkoll te mesme. OE i rekomanduar per kotrnate e ka sjelle listën me te gjitha profilet e kerkuara per dy pozita prej tyre ku ka sjell nga dy per pozitat e kërkuara. OE i rekomanduar i ka tejkualuar edhe me certifiakta Iso qe jan kërkuar ne DT, poashtu e tejkalon edhe vlerën e kërkuar prej 30 milion te kërkuar ne DT, ka ofruar edhe garancionin me te gjate te punëve te kryera, bazuar ne çmimin e ofruar dhe garancionin e ofruar, oferta e OE te rekomadnuar per kotrnate ka dal te jet ekonomikisht me e favorshme. Edhe ne ekspertizat e eksperteve teknike dhe profesional thuhet se i plotëson kërkesat e DT-se. OE i rekomadnuar per kontrate ne ofertën e tij i ka ofruar dy dëshmi nga dy banka, njëra 3 milion dhe tjetra 3.4 milion. Sa i përket çështja e referencave te OE te rekomanduar, i njëjti e ka prezantuar listën me vlere prej mbi 30 milion dhe i njëjti ka ofertuar si i vetem pra jo si konzorcium sepe AK-ja ka kekruar 25 milion kontrata dhe referenca ndersa OE i rekomanduar per kontrate e ka ofruar mbi 30 milion euro.

Në vazhdim fjalën iu dha edhe ekspertit shqyrtues/Teknik z. Liridon Gashi i cili deklaroi: ne lidhje me pretendimin e OE ankues per dyert X- ray, referenca e AK-se, ne raport thuhet se

komisioni gjate punës ka verifikuar funksionimin e dyerve dhe ka kekruar përmirësimin e vërejtjeve te evidentuara gjate punës ne teren. Me qellim te verifikimit te funksionimit permenden dyert, raporti eshte pjesërisht i pranuar, ka qene e pamundshme te vlerësohet nëse dyert janë te pranuar ose jo, dhe e dyta ne baze te specifikave eshte kërkuar dyer X-Ray, me hapje automatike ndersa ne raportin vlerësues permenden dyer hermatike me inox me veshje plumbi pa u specifikuar hapja automatike. Per shkak te këtyre paqartësive eshte len mundësia qe ne baz e te nenit 72 te LPP-se te behet plotësimi i dokumentacionit ne rast te rivlerësimit. Sa i perket pretenimit per ekseprt te sigurisë, ne dokumentacion eshte verifikuar gjendet vetëm vendim e jo certifikat sipas kërkesës se DT-se. Pretendimi nr. 4 per 12 udheheqes per disa janë te mbikuliafikuar dhe si te till e kan plotësuar kushtin ndersa dy prej tyre nuk kan diplom te shkollës se mesme as certifikatat te trupave te akredituar nga AKK. Sa i përket pikës tjetër, referencave ne i kemi pasur disa paqartësi, psh: ndërtimi i stadiumit te Gjilanit, kontrata eshte me AL-trade Shpk, ndersa referenca me bau holding L.L.C, poashtu shuma e kontratës edhe shuma e referencës kan mospërputhje. Sa i përket ndërtimit staiumve ndihmese ne Gjilan, Pej, Drenas dhe Studenqan, ne referencën e lëshuar nga AK-MKRS, “reference pozitive... prej fillimit te kontratës deri me sot janë realizuar pune.... ne vlere 705,018.70 euro, ndersa vlere e kontratës eshte 1,987,110.60 euro”. Te kontarta renovimi i stadiumit renovimi i Gjakove, te referenca e lëshuar nga MKRS-ja, “reference pozitive.... prej fillimit te kontratës deri me dot jan e realizuar pune ne vlere 417,991.32 euro” ndersa ne kontrate eshte shuma 1,056,608.56 euro. Te nderimi i parkut industrial ne Miradi ne referencën e lëshuar nga Bau Holding citoj: “... ne punimet qe po zhvillohen ne projektin e parkut industrial ne Miradi” nga fjalia nenkuptojm se keto punime nuk janë te përfunduara. Ne dokumentacion eshte gjetur edhe kontrate e cila eshte vetëm furnizim.

Në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE ankues Ada Consulting Group - z. Salihu, rreth deklarimit te perfaqesuesit te AK-se lidhur me pretendimin nr. 1 konsiderojm se përfaqesuesi qëllimisht po i shmanget faktit se ne kriteret e kërkua ne DT, kanë qene tri alternative, kapitali, paraja e gatshme dhe letra mbështese dhe ne momentin qe njëra prej këtyre e ploteson konsiderohet se kriteri eshte përmbushur. Per me tepër ne vendimin e saj kur ka konstatuar se OE i rekomanduar per kontrate e narracioni i letrës mbështese konsiston ne te njëjtën prizëm sic eshte edhe te OE ankues, per te ja u ilustruar banka ne letren e OE te rekoamnuar per kotrnate “dëshirojmë te ju lajmrojme se banka merr ne kosiderat” ndersa tek letra mbështese e bankës se OE ankues eshte shkruar, “rrjedhimisht procredit bank do ta konsideroje” qe po të vlerësohet drejt te dy bankat do ta marrin ne konsderat duke u bazuar ne politikat e tyre”.

Sa i përket dyerve X-Ray, ka pasur dokumentin e paramases ne te cilën shkruan, fabrikimi, sjelljen, montimin e derës reshqitese me dimensione 160x220 dera eshte nje kriheshe dhe me mbrojtje x-ray, dhe e cila eshte e pranuar prej inxhinierëve te QKUK-se. Mendoj qe nuk ishin plotesu këto te dhëna salla operative nuk kishte mundur te perdoret. Pjesa e pranimi teknik e kan shënuar dere hermatike. Mendoj se kemi dhen fakte te mjaftushme per plotësimin e kesaj kërkesës, meqenëse QKUK-ja eshte pjese perberse e MSH-se kan mundur te bëjnë pyetje pran QKUK-se. Se te njëjtat janë dyer x-ray, e vërteton edhe agjensioni i fizikes berthamore.

Në vazhdim Eksperti Teknik, deklaroi se për dyert x-ray nuk ka referencë e cila specifikon hapjen automatike të dyerve x-ray.

Në vazhdim fjalën iu dha përfaqësuesit të OE të rekomanduar për kontratë z. Bajraktari, i cili deklaroi se në pajtim me nenin 11 të LPPA-se duke qenë se si pal me interes, në këtë çështje u sqaruan pjesa dërmuese e pretendimeve, si dhe të atyre të cekura në super ekserptizë, të datës: 15.08.2024. Sqarimet i dorëzoi edhe me shkrim në një dokument prej 7 faqesh si dhe dokumentet tjera të bashkangjitura, të cilat besojmë se PSH-se, do t'i ndihmojnë në drejtim të vendosjes së drejtë në lidhje me këtë çështje ndonjëherë janë tejkaluar afatet e përcaktuara me ligj, për faktin se më tepër se 4 muaj kur është dorëzuar aneksa. Sqarimet janë dhënë në atë dokument ndërsa në do të japim pikëpamje shtesë, në lidhje me punët kryera – referencë, të cilat dëshmojnë katërçipërisht dëshmojnë përtej standardit minimal prej 25 milion euro, poshtu dëgjova edhe sqarimin e ekspertit teknik dhe përdorisa po fliste e bëra një kalkulim të thjeshtë dhe duke qenë se vlera që kemi ofruar është mbi 30 milion dhe minusimi i disa vlerave të vogla që janë punë në proces është përtej limitit minimal të kërkuar.

Ndërsa sa i përket çështjes së garancionit bankar, e kemi ofruar edhe në dokumentin sqarues, faqe nr. 6 ku ekspertet nuk e kanë kontaktuar fare bankën ku e kemi konfirmimin që e njëjta nuk është kontaktuar fare. Prandaj një pretendim i tillë është i pa bazuar. Në fund vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të pa bazuara dhe vendosja e drejtësisë do të mund të bëhet vetëm përmes konfirmimit si të drejtë dhe të ligjshme të vendimit të AK-se.

-Gjetjet dhe konstatimet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale të tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues gjatë ekzaminimit të aktivitetit të prokurimit ka vërejtur se gjatë vlerësimit të ofertave pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit, autoriteti kontraktues nuk i ka zhvilluar

procedurat e vlerësimit në harmoni me nenin 59 të LPP-se dhe nenin 72 të LPP-se.

Paneli shqyrtues konstaton se lidhur me operatorin ekonomik “ÄK-Invest Dooel”, autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së dhe poashtu nuk ka vepruar në harmoni me nenin 72 të LPP-së pasi që nuk ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me kontrat e punës për stafin e ofruar. OE në fjalë ka ofruar kontratat të noterizuara nga kopja ndërkaq kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë: “kontrata të noterizuara”, andaj paneli shqyrtues vlerëson se AK ka qenë dashur që konform nenit 72- informacione shtesë të verifikojë kontratat në fjalë, për të verifikuar se a janë këto kontrata sipas kërkes së dosjes së tenderit, si dhe të bëjë verifikimin për letra bankare nga tri banka Halk bank, Shpakase dhe Stopanska Banka, andaj paneli shqyrtues e obligon AK-në që gjatë rivlerësimit të veprojë konform nenit 72 të LPP-së.

Poashtu paneli shqyrtues vlerëson AK gjatë vlerësimit të tenderëve ka qenë dashur të kërkojë informacione shtesë lidhur me referencat bankare, më saktësisht dëshmitë e bankës për qasje të pakushtëzuar në kredi. Eksperti i OSHP-së ka kërkuar sqarime shtesë nga bankat e cituara në super ekspertizë, por nuk ka marrë përgjigje, andaj paneli shqyrtues i OSHP-së konstaton se AK duhet të veprojë ashtu sic është paraparë në nenin 72 të LPP-së dhe të kërkojë sqarime shtesë lidhur me dëshmitë bankare.

Në rastin konkret paneli shqyrtues, ka vërejtur se autoriteti kontraktues, në zbatim të nenit 59 dhe 72 të LPP-se, është dashur që të kërkojë sqarime shtesë lidhur me dëshmitë e dorëzuara nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këto aktivitet të prokurimit.

Sa i përket operatorit ekonomik “Ada Consulting” paneli shqyrtues gjithashtu vlerëson se AK ka qenë dashur të kërkojë sqarime shtesë lidhur me garancionin/dëshmitë bankare për kredi të pakushtëzuar në vlerë prej 4,000. 000.00-euro në mënyrë që të bëjë verifikimin se a është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit, andaj paneli shqyrtues obligon AK-në që gjatë rivlerësimit të veprojë sipas nenit 72 të LPP-së.

Lidhur me arsyen e dytë të eliminimit të OE “Ada Consulting” se i njëjti “Nuk ka dëshmuar punë të kryera për detyrë X- ray Automatike. Lidhur me punimet me X-ray të Klinikës së Ortopedisë, për këtë projekt mungon pranimiti teknik”, paneli shqyrtues konstaton se AK edhe në këtë pikë duhet të veprojë sipas nenit 72 të LPP-së, të kërkojë sqarime shtesë lidhur me raportin e pranimit, më saktësisht të kërkojë dëshmi për këtë pikë të dosjes së tenderit. AK duhet të kërkojë sqarime shtesë nëse ky projekt ka përfunduar dhe është pranuar në tërësi nga AK-QKUK duke përfshirë edhe “Dyert XRay me hapje automatike”, në pajtim me dispozitat e nenit 72 të LPP-së për dokumente ekzistenca të cilave në mënyrë objektive mund të vërtëtohet se kanë ekzistuar para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.

Ndërkaq lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues “Nika Proing” paneli shqyrtues vlerëson se të njëjtat janë të paqëndrueshme pasi që nga ekspertiza është sqaruar mjaftueshëm se pas analizimit të cmimit total të shënuar tek përshkrimi i cmimeve dhe cmimit total të dhënë në paramasë, cmimi total i dhënë tek përshkrimi i cmimeve është 20,310,834.88 €, ndërsa cmimi total i dhënë në formular të dorëzimit të tenderit është 80,310,834.88 €. Andaj paneli shqyrtues

në rastin konkret vlerëson se nuk kemi të bëjmë me gabim në llogaritje apo aplikim të normës së duhur të TVSH-së, pasi gabimi në normë të TVSH-së mund të jetë 0 deri 18%, mirëpo kemi të bëjmë me mos përputhje të cmimit total të ofertës të dhënë në formular të tenderit dhe cmimit total në përshkrim të cmimeve. Ky problem është i rregulluar në mënyrë eksplicite përmes Rregullorës për Prokurim Publik 001/2022: neni 40.10 pika (b): b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

Llidhur me planin dinamik të OE ankues "Mabco Constrection" paneli shqyrtues vlerëson se duke qenë se nuk ka legjislacion në fuqi në fushën e ndërtimit në Kosovë, dhe nuk është vërtuar mjaftueshëm se a është apo jo plani dinamik i ofruar nga OE në harmoni me dosjen e tenderit, paneli shqyrtues vlerëson se AK duhet të kërkojë gjatë rivlerësimit sqarime shtesë nga OE për planin e ofruar.

Poashtu paneli shqyrtues obligon AK-në që në procedurat të prokurimit të ketë parasysh nenin 108/A të LPP-së gjatë përgjigjes në kërkesën për rishqyrtim.

Duke ju referuar shkresave të lendes, raportit të super ekspertizës dhe deklaramit të palëve në seancën degjimore u vërtetua fakti se edhe në ofertën e rekomanduarit për kontratë ka dëshmi të cilat nuk janë në përputhje të plote me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, dëshmi të cilat duhet AK-ja të sqaroj në bazë të nenit 72 të LPP-se, paneli shqyrtues aktivitetin e prokurimit e kthen në rivlerësim.

Paneli shqyrtues e obligon autoritetin kontraktues, që shkeljet procedurale të konstatuara, të evitohet gjatë rivlerësimit të ofertave, duke pas parasysh këtu edhe pretendimet e OE-ve ankues të parashtruara në ankese, rrjedhimisht të aplikon nenin 72 të LPP-se dhe 59 të LPP-se, në mënyrë që të sqarohen dëshmit e kontestuara.

Paneli shqyrtues duke u mbështetur në nenin 105, paragrafi 2.10, konsideron se vendimi i marrë në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 6 si dhe nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese.

OSHP nisat nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon njohurinë e plotë në ushtrimet e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetin e buxhetit. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka qëndruar si në dispozitiv të vendimit të marrë, i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform ndikimit në dhe natyrës së çështjes në rastin konkret.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - MABCO CONSTRUCTIONS SH.P.K., MABCO CONSTRUCTIONS SH.P.K., NIKA PrO- Ing SH.P.K., AK INVEST DOOEL Tetovo**
- Arkivës së OSHP-së: